SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
"NAZMI RUSHITI"

Aftësi për Punë
Skills for Jobs

Vlerësimi institucional me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset

Shkolla Profesionale “Nazmi Rushiti” Dibër

Viti shkollor 2025 – 2026

Shtator 2026

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
"NAZMI RUSHITI"

Aftësi për Punë
Skills for Jobs

Tabela e përmbajtjes

Lista e Tabelave 3
Hyrje 5
Metodologjia 5
Të dhëna për pjesëmarrësit 7
Rezultatet 8
Zhvillimi i vazhduar profesional 8
Kurrikula 9
Marrëdhënia me biznesit 10
Orientimi në karrierë 11
Projektet 11
Marketingu 12
Gjurmimi në nivel ofruesi 14
Shtojca 1 – Tabela exel me të dhënat nga sondazhi 15

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup 7
Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional 8
Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës 9
Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin 10
Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë 11
Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve 11
Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut 12
Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi 14

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
"NAZMI RUSHITI"

Aftësi për Punë
Skills for Jobs

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" (S4J)

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Swisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti "Aftësi për Punë" (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përftuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
"NAZMI RUSHITI"

Aftësi për Punë
Skills for Jobs

Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet nga procesi i **Vlerësimit Institucional** të zhvilluar në Shkollën **"Nazmi Rushiti"** për vitin shkollor 2025 - 2026. Procesi, me synim vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të aftësimit profesional, përfshiu nxënës, mësues, prindër dhe biznese partnere, të cilët u anketuan gjatë periudhës maj-qershor 2026.

Procesi u koordinua nga Njësia e Zhvillimit (NjZH) në shkollë, e cila luan një rol kyç në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Përshkrimi i gjetjeve në raport është i organizuar sipas treguesve për secilin funksion të NJZH-së.

Ky proces vlerësues mbështetet në përvojën e vitit shkollor 2024 - 2025, ku projekti 'Aftësi për Punë' (S4J), në bashkëpunim me gjashtë shkolla partnere[1], zhvilloi katër instrumente vlerësimi (pyetësorë), të bazuar në një metodologji rigoroze dhe pjesëmarrëse. Pas pilotimit në gjashtë shkolla, instrumentet u rishikuan për të garantuar vlefshmëri, qëndrueshmëri dhe respektim të standardeve etike[2].

Metodologjia

Në kuadër të mbledhjes së informacionit që do të ushqejë analizën vjetore të performancës institucionale, në përfundim të çdo viti shkollor do të realizohet një proces vlerësimi institucional në nivel ofruesi duke përfshirë katër grupeve kryesore: nxënës, mësues, biznese dhe prindër. Ky proces synon të vlerësojë performancën institucionale, të identifikojë fushat për përmirësim dhe të informojë objektivat e planit vjetor të institucionit.
Për këtë qëllim, janë zhvilluar katër instrumente vlerësimi (pyetësor), si vijon:

Pyetësori për nxënësit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e nxënësve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në cilësinë e mësimdhënies, praktikën profesionale, orientimin në karrierë dhe performancën e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i programeve për të përgatitur më mirë nxënësit për tregun e punës.

Pyetësori për mësuesit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e mësuesve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional dhe mjedisit të të nxënit. Fokusohet në zhvillimin profesional, zbërthimin e kurrikulës, projektet zhvillimore dhe dhe performancën e institucionit. Qëllimi është identifikimi i fushave për përmirësim dhe përshtatja e praktikave me nevojat e stafit dhe nxënësve.

Pyetësori për bizneset synon të mbledh perceptimet e bizneseve për cilësinë e bashkëpunimit me institucionin dhe përvojën me nxënësit gjatë praktikës profesionale. Fokusohet në përgatitjen e nxënësve, përputhshmërinë e programeve të praktikës me nevojat e tregut të punës dhe mundësitë për përmirësim.

[1] Hamdi Bushati, Kolin Gjoka, Kristo Isak, Shkolla Profesionale Elbasan, Shkolla Teknike Ekonomike Tirane, Tregtare.
[2] Për më shumë informacion, shih raportin Baseline i treguesve të cilësisë së Njësisë së Zhvillimit https://skillsforjobs.al/publications/baseline-i-treguesve-te-cilesise-se-njesise-se-zhvillimit/

Qëllimi është forcimi i bashkëpunimit dhe angazhimi cilësor i sektorit privat në proceset e aftësimit profesional.

Pyetësori për prindërit synon të mbledhë mendimet e prindërve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në komunikimin me shkollën, orientimin në karrierë të fëmijëve dhe imazhin e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i shërbimeve për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat e nxënësve dhe prindërve.

Të dhëna për pjesëmarrësit

Për vitin shkollor 2025-2026, në shkollën profesionale "Nazmi Rushiti" morën pjesë në sondazh gjithsej 131 nxënës. Përbërja gjinore e të anketuarve tregon se 56,5% (N=74) ishin vajza, 42,7% (N=56) ishin djem, ndërsa 0,8% (N=1) kanë preferuar të mos përgjigjen. Sa i përket shpërndarjes sipas klasave, 28,2% (N=37) e nxënësve ishin në klasën e dhjetë, 27,5% (N=36) në klasën e njëmbëdhjetë, 4,6% (N=6) në klasën e dymbëdhjetë, 38,9% (N=51) në klasën e trembëdhjetë, ndërsa 0,8% (N=1) në arsimin profesional pas të mesëm.

Për vitin shkollor 2025-2026, në sondazh morën pjesë gjithsej 14 mësues të shkollës profesionale "Nazmi Rushiti". Përbërja gjinore e të anketuarve tregon se 57,1% (N=8) ishin gra, ndërsa 42,9% (N=6) ishin burra. Sa i përket grupit të lëndëve në të cilat japin mësim mësuesit e anketuar, 7,1% (N=1) japin mësim në lëndët e teorisë profesionale, 7,1% (N=1) në modulet e praktikës profesionale, ndërsa 85,7% (N=12) japin mësim si në lëndët e teorisë profesionale, ashtu edhe në modulet e praktikës profesionale.

Për bizneset partnere të shkollës profesionale "Nazmi Rushiti", në sondazh morën pjesë gjithsej 29 biznese. Sa i përket bashkëpunimit me shkollën gjatë vitit shkollor, 60,7% (N=17) e bizneseve deklarojnë se kanë bashkëpunim të ngushtë, 28,6% (N=8) kanë bashkëpunim të mirë, 7,1% (N=2) kanë bashkëpunim mesatar, ndërsa 3,6% (N=1) deklarojnë se nuk kanë bashkëpunim me shkollën. Për këtë tregues, 1 biznes nuk ka dhënë përgjigje. Sa i përket formave të bashkëpunimit, 100,0% (N=29) e bizneseve të anketuara deklarojnë se bashkëpunojnë me shkollën përmes mbi 5 modaliteteve të bashkëpunimit.

Për prindërit e nxënësve të shkollës profesionale "Nazmi Rushiti", në sondazh morën pjesë gjithsej 58 prindër. Përbërja gjinore e të anketuarve tregon se 55,2% (N=32) ishin gra, 41,4% (N=24) ishin burra, ndërsa 3,4% (N=2) kanë preferuar të mos përgjigjen. Sa i përket klasës ku ndjek shkollën fëmija, 17,5% (N=10) e prindërve kanë deklaruar se fëmija i tyre ndjek klasën e dhjetë, 36,8% (N=21) klasën e njëmbëdhjetë, 3,5% (N=2) klasën e dymbëdhjetë, ndërsa 42,1% (N=24) klasën e trembëdhjetë. Një prind nuk ka dhënë përgjigje për këtë pyetje.

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup

Përfituesit	**2025**	**2026**
Nxënës	126	131
Mësues	36	14
Prindër	116	58
Biznese	8	29

Rezultatet

Seksionet më poshtë përmbledhin rezultatet e matjeve me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset. Ndërkohë, listën e plotë të gjetjeve për cdo pyetësor e gjeni në Shtojcën 1.

Zhvillimi i vazhduar profesional

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 27,8% në vlerësimin se aktivitetet e ZHVP-së janë në përputhje me nevojat e mësuesve, nga 72,2% në 2025 në 100,0% në 2026. Vlerësimi se aftësitë e mësuesve janë përmirësuar nga trajnimet dhe aktivitetet e parashikuara në planin e ZHVP-së është rritur me 2,4%, nga 83,3% në 2025 në 85,7% në 2026. Ndërkohë, kënaqësia e mësuesve me mbështetjen që kanë marrë gjatë zbatimit të planit të ZHVP-së është rritur me 17,1%, nga 82,9% në 2025 në 100,0% në 2026. Aplikimi në mësimdhënie i njohurive, aftësive, shprehive dhe metodave të reja të mësimdhënies të përfituara nga trajnimet dhe shkëmbimet është rritur me 10,5%, nga 82,4% në 2025 në 92,9% në 2026.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 16,5% në kënaqësinë e nxënësve me metodat e mësimdhënies, nga 65,9% në 2025 në 82,4% në 2026. Kënaqësia e nxënësve me metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies është rritur me 37,7%, nga 42,6% në 2025 në 80,3% në 2026. Ndërkohë, kënaqësia e nxënësve me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor është rritur me 6,1%, nga 68,7% në 2025 në 74,8% në 2026.

Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit e kulturës profesionale – përfitues direkt	1. Aktivitetet e ZHVP janë në përputhje me nevojat e mësuesve.	72.2%	100.0%
	2. Aftësitë e mësuesve janë përmirësuar nga trajnimet/aktivitetet e parashikuara në planin e ZHVP.	83.3%	85.7%
	3. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë gjatë zbatimit të planit të ZHVP.	82.9%	100.0%
	4. Mësuesit aplikojnë në mësimdhënie njohuritë aftësitë, shprehitë dhe metodat e reja të mësimdhënies që kanë mësuar në trajnime dhe shkëmbime.	82.4%	92.9%
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies (si p.sh., puna në grup, puna me projekte, përdorimi i teknologjisë, ndërveprimi në klasë etj.).	65.9%	82.4%

	2. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies.	42.6%	80.3%
	3. Nxënësit janë të kënaqur me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor.	68.7%	74.8 %

Kurrikula

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 13,5% në vlerësimin e mësuesve se e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës në përputhje me nevojat rajonale të tregut të punës, nga 72,2% në 2025 në 85,7% në 2026. Kënaqësia e mësuesve me mbështetjen që kanë marrë nga koordinatori i kurrikulës për zbatimin e mësimdhënies është rritur me 6,8%, nga 86,1% në 2025 në 92,9% në 2026.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 9,7% në vlerësimin e nxënësve se programi mësimor është i përshtatur me tregun e punës, nga 77,3% në 2025 në 87,0% në 2026.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 30,6% në kënaqësinë e bizneseve me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që kanë marrë nxënësit në shkollë, nga 62,5% në 2025 në 93,1% në 2026. Ndërkohë, vlerësimi i bizneseve se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre është rritur me 0,9%, nga 75,0% në 2025 në 75,9% në 2026.

Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës në përputhet me nevojat rajonale të tregut të punës.	72.2%	85.7%
	2. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë nga koordinatori i kurrikulës për zbatimin e mësimdhënies	86.1%	92.9%
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit mendojnë se programi mësimor është e përshtatur me tregun e punës.	77.3%	87.0%
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset janë të kënaqur me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që kanë marrë nxënësit në shkollë.	62.5%	93.1%
	2. Bizneset mendojnë se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre.	75.0%	75.9%

Marrëdhënia me biznesit

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 33,2% në përqindjen e nxënësve që kanë bërë praktikë profesionale në biznes, nga 62,5% në 2025 në 95,7% në 2026. Në të kundërt, niveli i kënaqësisë së nxënësve me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale në biznes është ulur me 2,5%, nga 72,7% në 2025 në 70,2% në 2026. Ndërkohë, niveli i kënaqësisë së nxënësve me realizimin e praktikës profesionale në biznes sipas planit të praktikës është rritur me 0,4%, nga 72,7% në 2025 në 73,1% në 2026.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 25,0% në përqindjen e bizneseve që bashkëpunojnë në forma të ndryshme me shkollën, nga 75,0% në 2025 në 100,0% në 2026. Kënaqësia e bizneseve për bashkëpunimin me shkollën është rritur me 31,5%, nga 50,0% në 2025 në 81,5% në 2026. Në të kundërt, përqindja e bizneseve që bashkëpunojnë ngushtë me shkollën është ulur me 39,3%, nga 100,0% në 2025 në 60,7% në 2026. Kënaqësia e bizneseve me cilësinë e përgatitjes së nxënësve nga shkolla është rritur me 30,6%, nga 62,5% në 2025 në 93,1% në 2026. Vlerësimi i bizneseve se shkolla përmbush nevojat e biznesit për aftësi cilësore pune është ulur me 2,9%, nga 85,7% në 2025 në 82,8% në 2026. Ndërkohë, njohja e programit mësimor që ofron shkolla nga bizneset është rritur me 28,8%, nga 33,3% në 2025 në 62,1% në 2026. Së fundi, njohja shumë e mirë e moduleve profesionale që ofron shkolla nga bizneset është rritur me 14,3%, nga 50,0% në 2025 në 64,3% në 2026.

Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. % e nxënësve që kanë bërë praktikë profesionale në biznes.	62.5%	95.7%
	2. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale në biznes.	72.7%	70.2%
	3. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me realizimin e praktikës profesionale në biznes sipas planit të praktikës.	72.7%	73.1%
Bizneset – përfitues direkt	1. Bizneset bashkëpunojnë në forma të ndryshme me shkollën.	75.0%	100.0%
	2. Bizneset janë të kënaqura për bashkëpunimin me shkollën.	50.0%	81.5%
	3. Bizneset bashkëpunojnë ngushtë me shkollën.	100%	60.7%
	4. Bizneset janë të kënaqur me cilësinë e përgatitjes së nxënësve nga shkolla.	62.5%	93.1%
	5. Bizneset mendojnë se shkolla përmbush nevojat e biznesit për aftësi cilësore pune.	85.7%	82.8%
	6. Biznesi njeh programin mësimor që ofron shkolla.	33.3%	62.1%
	7. Biznesi njeh shumë mirë modulet profesionale qe ofron shkolla.	50.0%	64.3%

Orientimi në karrierë

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një ulje prej 5,2% në përqindjen e nxënësve që kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë, nga 92,9% në 2025 në 87,7% në 2026. Në të kundërt, kënaqësia e nxënësve me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit në karrierë është rritur me 15,6%, nga 69,2% në 2025 në 84,8% në 2026. Gjithashtu, përqindja e nxënësve të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që po studiojnë është rritur me 19,7%, nga 45,7% në 2025 në 65,4% në 2026.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 16,7% në kënaqësinë e prindërve me shërbimin për orientim në karrierë që shkolla i jep fëmijës, nga 60,7% në 2025 në 77,4% në 2026. Gjithashtu, besimi i prindërve se orientimi në karrierë e ka ndihmuar fëmijën për të marrë vendimet e duhura për karrierën është rritur me 15,2%, nga 70,0% në 2025 në 85,2% në 2026.

Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë.	92.9%	87.7%
	2. Nxënësit janë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit në karrierë.	69.2%	84.8%
	3. Nxënësit janë të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që po studiojnë.	45.7%	65.4%
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit janë të kënaqur me shërbimin për orientim në karrierë që i jep shkolla fëmijës.	60.7%	77.4%
	2. Prindërit besojnë se orientimi në karrierë e ka ndihmuar fëmijën për të marrë vendimet e duhura për karrierën.	70.0%	85.2%

Projektet

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 30,0% në përqindjen e mësuesve që i njohin projektet zhvillimore të shkollës, nga 62,9% në 2025 në 92,9% në 2026. Përqindja e mësuesve që mendojnë se projektet zhvillimore të shkollës përmirësojnë cilësinë e arsimit është rritur me 40,1%, nga 52,8% në 2025 në 92,9% në 2026. Ndërkohë, përfshirja e mësuesve në shkrimin e projekteve zhvillimore si pjesë e grupeve të punës është rritur me 7,9%, nga 27,8% në 2025 në 35,7% në 2026. Në të njëjtin nivel, përfshirja e mësuesve në zbatimin e projekteve zhvillimore është rritur me 7,9%, nga 27,8% në 2025 në 35,7% në 2026.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 15,1% në përqindjen e nxënësve që janë në dijeni të projekteve zhvillimore në shkollë, nga 61,2% në 2025 në 76,3% në 2026. Në të kundërt, përfshirja e nxënësve në projekte zhvillimore është ulur me 7,3%, nga 65,2% në 2025 në 57,9% në 2026. Gjithashtu, kënaqësia e nxënësve me përfshirjen në aktivitetet e projekteve të zhvilluara nga shkolla është ulur me

3,5%, nga 73,9% në 2025 në 70,4% në 2026. Ndërkohë, kënaqësia e nxënësve me rezultatet e projekteve të zbatuara nga shkolla është rritur me 7,8%, nga 75,5% në 2025 në 83,3% në 2026.

Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit i njohin projektet zhvillimore të shkollës	62.9%	92.9%
	2. Mësuesit mendojnë se projektet zhvillimore të shkollës përmirësojnë cilësinë e arsimit	52.8%	92.9%
	3. Mësuesit janë të përfshirë në shkrimin e projekteve zhvillimore si pjesë e grupeve të punës	27.8%	35.7%*
	4. Mësuesit janë të përfshirë zbatimin e projekteve zhvillimore.	27.8%	
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit janë të dijeni të projekteve zhvillimore në shkollë.	61.2%	76.3%
	2. Nxënësit janë të përfshirë në projekte zhvillimore	65.2%	57.9%
	3. Nxënësit janë të kënaqur me përfshirjen në aktivitete të projekteve të zhvilluara nga shkolla.	73.9%	70.4%
	4. Nxënësit janë të kënaqur me rezultatet e projekteve të zbatuara nga shkolla.	75.5%	83.3%

Shënim: *Treguesit 3 dhe 4 janë llogaritur vetëm për mësuesit që raportuan pjesëmarrje në grupet e punës për projektet zhvillimore (N=5; 37.5% e kampionit total të shkollës).

Marketingu

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 30,6% në kënaqësinë e mësuesve me aktivitetet e planit të marketingut të shkollës, nga 69,4% në 2025 në 100,0% në 2026. Në të kundërt, vlerësimi i mësuesve se materialet informuese për marketingun janë cilësore është ulur me 18,4%, nga 72,2% në 2025 në 53,8% në 2026. Ndërkohë, kënaqësia e mësuesve me imazhin që ka shkolla është rritur me 22,2%, nga 77,8% në 2025 në 100,0% në 2026. Gjithashtu, përfshirja e mësuesve në aktivitetet e marketingut të shkollës është rritur me 14,2%, nga 42,9% në 2025 në 57,1% në 2026.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një ulje prej 38,0% në kënaqësinë e nxënësve me aktivitetet e marketingut të shkollës, nga 66,7% në 2025 në 28,7% në 2026. Kënaqësia e nxënësve me cilësinë e

informacionit të dhënë në materialet e marketingut është ulur me 4,8%, nga 67,7% në 2025 në 62,9% në 2026. Në të kundërt, kënaqësia e nxënësve me imazhin e shkollës është rritur me 10,2%, nga 66,9% në

2025 në 77,1% në 2026. Përfshirja e nxënësve në aktivitetet e marketingut është ulur me 6,1%, nga 34,8% në 2025 në 28,7% në 2026.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një ulje prej 1,3% në përqindjen e bizneseve që e vlerësojnë shkollën si institucion me reputacion dhe imazh të mirë, nga 87,5% në 2025 në 86,2% në 2026.

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 20,6% në përqindjen e prindërve që e vlerësojnë shkollën si institucion me imazh të mirë, nga 51,3% në 2025 në 71,9% në 2026.

Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues indirekt	1. Mësuesit janë të kënaqur me aktivitetet e planit të marketingut të shkollës.	69.4%	100.0%
	2. Mësuesit mendojnë se materialet informuese për marketingun janë cilësore	72.2%	53.8%
	3. Mësuesit janë të kënaqur me imazhi që ka shkollë	77.8%	100.0%
	4. Mësuesit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut të shkollës.	42.9%	57.1%
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me aktivitetet e marketingut të shkollës	66.7%	28.7%
	2. Nxënësit mendojnë se informacioni i dhënë në materialet e marketingut është cilësor.	67.7%	62.9%
	3. Nxënësit janë të kënaqur me imazhit të shkollës.	66.9%	77.1%
	4. Nxënësit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut.	34.8%	28.7%
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset e vlerësojnë shkollën si institucion me reputacion/ imazh të mirë.	87.5%	86.2%
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit e nxënësve të shkollës dhe nxënësve të klasave të 8-9 vlerësojnë shkollën si institucion me imazh të mirë.	51.3%	71.9%

Gjurmimi në nivel ofruesi

Krahasimi i vitit 2026 me vitin 2025 tregon një rritje prej 8,3% në përqindjen e drejtuesve dhe mësuesve që përdorin të dhënat e gjurmimit për përmirësimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të lidhura me të, nga 41,7% në 2025 në 50,0% në 2026. Gjithashtu, përqindja e vlerësimit se shkolla i përdor të dhënat e gjurmimit për përmirësimin e aktivitetit vjetor është rritur me 27,0%, nga 44,4% në 2025 në 71,4% në 2026.

Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Drejtuesi dhe Mësuesit – përfitues direkt	1. Drejtuesit dhe mësuesit përdorin të dhënat e gjurmimit për të përmirësuar procesin mësimor dhe aktivitetet e lidhura me të.	41.7%	50.0%
	2. Shkolla i përdor të dhënat e gjurmimit për përmirësimin e aktivitetit vjetor	44.4%	71.4%

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit për shkollën “Nazmi Rushiti”. Krahasimet për mësuesit duhen interpretuar duke marrë parasysh pjesëmarrjen e 14 personave në 2026, nga 36 në 2025. Për bizneset, rekomandimet mbështeten kryesisht në rezultatet e vitit 2026, pasi në 2025 u përgjigjën vetëm 8 biznese.

1. Të kuptohet pakënaqësia e nxënësve me aktivitetet e marketingut

Njësia e Zhvillimit të diskutojë me nxënësit çfarë i bën aktivitetet e marketingut pak të dobishme për ta dhe t’i përfshijë në planifikimin e aktiviteteve të ardhshme. Materialet informuese të rishikohen me kontributin e nxënësve dhe mësuesve.

Gjetja: Kënaqësia e nxënësve me aktivitetet e marketingut ra nga 66.7% në 28.7%, ndërsa përfshirja e tyre nga 34.8% në 28.7%. Në të kundërt, kënaqësia e mësuesve me aktivitetet është 100.0%. Vlerësimi i mësuesve për cilësinë e materialeve informuese ra nga 72.2% në 53.8%. Dallimi mes vlerësimeve kërkon diskutim para përcaktimit të ndryshimeve.

2. Organizim më cilësor i praktikës në biznes

Pas çdo periudhe praktike të mblidhen vlerësimet e nxënësve për detyrat, mbështetjen nga mentorët dhe realizimin e planit. Planet e praktikës të diskutohen me bizneset pritëse dhe të përshtaten sipas çështjeve të identifikuara.

Gjetja: Përqindja e nxënësve që kryejnë praktikë në biznes u rrit nga 62.5% në 95.7%, por kënaqësia me mundësitë e praktikës është 70.2% dhe me realizimin sipas planit 73.1%. Në 2026, 75.9% e bizneseve i vlerësojnë planet e praktikës si të përshtatura me nevojat e tyre.

3. Komunikim më i rregullt me bizneset për programin mësimor

Shkolla të organizojë takime të shkurtra me bizneset partnere për të prezantuar programin, modulet profesionale dhe aftësitë që nxënësit pritet të zhvillojnë. Takimet të përdoren edhe për të mbledhur sugjerime për praktikën dhe bashkëpunimin.

Gjetja: Megjithëse 93.1% e bizneseve vlerësojnë pozitivisht përgatitjen e nxënësve, vetëm 62.1% deklarojnë se njohin programin mësimor dhe 64.3% se njohin shumë mirë modulet profesionale. Bashkëpunim të ngushtë me shkollën raportojnë 60.7% e bizneseve me përgjigje të vlefshme.

4. Orientim në karrierë me informacion konkret për punësimin

Sesionet e orientimit të përfshijnë informacion të përditësuar për mundësitë e punësimit sipas profilit, kërkesat e punëdhënësve dhe alternativat e vijimit të studimeve. Të përdoren gjetjet e gjurmimit dhe takimet me biznese e të diplomuar.

Gjetja: Kënaqësia e nxënësve me orientimin në karrierë u rrit nga 69.2% në 84.8%, por vetëm 65.4% ndihen të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit. Përqindja që ka marrë shërbime orientimi ra nga 92.9% në 87.7%.

5. Më shumë mundësi për pjesëmarrjen e nxënësve në projekte

Projektet në zbatim të prezantohen me mundësi të qarta pjesëmarrjeje për nxënësit nga klasa dhe profile të ndryshme. Të diskutohen pengesat për përfshirjen dhe të mblidhen sugjerime nga pjesëmarrësit për përmirësimin e aktiviteteve.

Gjetja: Njohja e projekteve nga nxënësit u rrit nga 61.2% në 76.3%, por përfshirja ra nga 65.2% në 57.9% dhe kënaqësia me pjesëmarrjen nga 73.9% në 70.4%. Ndërkohë, kënaqësia me rezultatet e projekteve u rrit në 83.3%.

6. Përdorim më i gjerë i të dhënave të gjurmimit

Gjetjet e gjurmimit të diskutohen rregullisht me ekipet lëndore dhe të përkthehen në veprime konkrete për mësimdhënien, praktikën dhe orientimin në karrierë. Në planin vjetor të dokumentohen vendimet që mbështeten në këto të dhëna.

Gjetja: Megjithëse treguesit janë përmirësuar, përdorimi i të dhënave të gjurmimit për përmirësimin e procesit mësimor raportohet nga 50.0% e drejtuesve dhe mësuesve. Vlerësimi se shkolla i përdor këto të dhëna për përmirësimin e aktivitetit vjetor është 71.4%.

Shtojca 1 – Tabela exel me të dhënat nga sondazhi

Shkolla Nazmi Rushiti_Indeksi.xlsx